Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-412
Datë: 16.11.2016

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 9, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

Vendim

1. Këshilli Drejtues i AKK miraton dhe aprovon kërkesa për lejim të aplikimit për validim dhe akreditim të institucionit vetëm për ato kualifikime për të cilat ekzistojnë standardet e profesionit të miratuara në nivel kombëtar.

2. Institucionit "MACC" nga Peja nuk i lejohet që të aplikojë ende për validim dhe akreditim për kualifikimet e poshtë shënuara, pasi që nuk janë aprovuar ende standardet e profesionit në nivel kombëtar:
   - Siguria dhe shëndeti në punë;
   - Proceset e menaxhimit të cilësisë 9001.

3. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që të njoftojë institucionin dhe të vazhdojë procesin sipas legjislacionit në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.

Nën- kryetari i KD së AKK
Anton Gojani